



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.315/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “GPG Company” SHPK & “Korsel” SHPK, “Rej” SHPK, “Alko Impex General Construction” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr REF-91787-03-30-2021 me objekt “*Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnjë*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës: 31 409 034 Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnjë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së BOE “GPG Company” SHPK & “Korsel” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së BOE “GPG Company” SHPK&“Korsel” SHPK dhe operatorit ekonomik “Rej” ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

“Leal” ShPK  
Lagjja “Kongresi i Lushnjës”, Rruga “Vojo Kushi”,  
Pallati Nr.134, kati i parë Lushnjë

“Rej” ShPK  
Zogu i Zi, Qatar Center, Kati i 2, Tiranë

“Alko Impex General Construction” ShPK  
Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Lushnjë  
Lagja Kongresi i Lushnjës

**Subjekt i Interesuar:** BOE “GPG Company” SHPK&“Korsel” SHPK  
Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit  
Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut. , Lushnje,  
Lushnje.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”,  
i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të  
Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e  
Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi  
i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë  
12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për  
Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të  
Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të  
Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë  
5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave  
Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së  
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë  
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr REF-91787-03-30-2021 me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnje”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës: 31 409 034 Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnjë.

II.2. Në datën 21.05.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.05.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- GPG&Korsel	23,619,593.6	I kualifikuar
- Rej	27,446,311.06	I kualifikuar
- Alko Impex General Contruction	28,224,135.88	I kualifikuar
- Leal	28,849,101	I kualifikuar

II.4. Në datën 01.06.2021 operatori ekonomik “Leal” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Operatorët pjesëmarrës nuk i kanë përmbushur kriteret e vendosura nga ana juaj:*

- *Operatori GPG Company nuk e ka të përfshirë në objektin e veprimtarisë në QKB veprimtarinë e shërbimit të pastrimit të qyteteve kjo në kundërshtim me ligjin dhe dispozitat në fuqi.*
- *Ortaku dhe administratori i kësaj kompanie në dijeninë tonë është i dënuar për evazion fiskal dhe mashtrim i shtetit nëpërmjet ngritjes së skemës për rimbursimin e TVSH. Deklarata e nënshkruar prej këtij administratori nuk është e rregullt pasi ai është i dënuar dhe ka mashtruar AK.*
- *Operatori Rej ShPK nuk ka mundur të paraqesë një mekanik me diplomë por ka paraqitur një certifikatë trajnimi nga institucione të paakredituar për dhënien e diplomave profesionale.*
- *Po ky operator nuk ka mundur të paraqesë pompën speciale për larjen e kazanëve por ka paraqitur autobot uji.*
- *Operatori Alko Impex General Construction ShPK nuk ka mundur të paraqesë një mekanik me diplomë por ka paraqitur një certifikatë trajnimi nga institucione të paakredituar për dhënien e diplomave profesionale*
- *Operatori Alko Impex General Construction ShPK nuk ka mundur të paraqesë analizën e kostos ashtu siç është kërkuar nga ana e juaj.*
- *Po ashtu ky operator nuk ka mundur të paraqesë pompën speciale për larjen e kazanëve por ka paraqitur autobot uji.*  
*Sa më sipër kërkojmë pranimin e ankesës si dhe skualifikimin e ofertave të cilat nuk janë hartuar në përputhje me kriteret e vendosura.*

II.5. Në datën 02.06.2021 me shkresën nr.3815/1 prot operatori ekonomik ankimues “Leal” ShPK ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 09.06.2021 operatori ekonomik ankimues “Leal” ShPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 01.06.2021 operatori ekonomik “Rej” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Duke gjykuar se kualifikimi i ofertës së paraqitur nga shoqëria G.P.G Company ShPK është në kundërshtim me ligjin dhe kriteret kualifikuese të përcaktuara nga AK në DT paraqesim këtë ankesë për sa më poshtë vijon:*
- *Duke qenë se shoqëria jonë ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e shërbimit të pastrimit e kryesisht atë të mbetjeve urbane kemi bindjen e plotë se shoqëria GPG Company nuk ka asnjë eksperiencë të ngjashme në këtë fushë. Konkretisht edhe nga një kërkim i kryer nga ana jonë në buletinin e prokurimeve publike nuk rezulton që kjo shoqëri të jetë shpallur fitues në ndonjë procedurë prokurimi të ngjashme me këtë procedurë objekt ankimi e për rrjedhojë kjo shoqëri nuk e plotëson kriterin e përvojës me institucione shtetërore. Për sa i përket pretendimit për realizim të kontratës me subjekte provate së pari çmojmë se faturat e paraqitura nuk janë të shoqëruara me*

*dokumentacionin përkatës dhe në to nuk shënohen saktë dhe qartë shërbimet e realizuara. Më tepër nga një kërkim i thjeshtë në faqen zyrtare të QKB nuk rezulton që kjo shoqëri të jetë e licencuar për asnjë prej veprimtarive të pretenduara të realizuara e si rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur është fiktiv dhe nuk plotëson ato parakushte të caktuara nga AK në DT.*

- *Së dyti nga AK në DT është kërkuar marrëveshje e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe b prokura e posaçme.*

*Referuar rregullave të prokurimit publik vërejmë se në kontratën e bashkëpunimit nuk përmbushen disa prej kërkesave të cilat janë parashikuar qartazi në dispozitat ligjore të sipërcituara e konkretisht:*

1. *Palët nuk kanë parashikuar në raport preventiv shërbimet që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të shoqërive.*
2. *Shoqëria GPG nuk plotëson kriterin lidhur me punën e ngjashme në raport me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit duke marrë në konsideratë edhe faktet e pretenduara më sipër.*
3. *Shoqëria GPG nuk plotëson kriterin lidhur me mjetet e kërkuara në raport me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.*

- *Gjithashtu në DT është kërkuar*

<i>Makine teknologjike per fshirjen e rrugeve, me kapacitet mbajtes 7-9 ton, te pajisura me 2 fshesa anesore (majtas dhe djathtas) dhe nje fshese qendrore rul, sistem thithes te pelhurave (aspirator) dhe sistem sperkatje me uji gjate punes, mundesisht me tub aspirimi te jashtem thithes,</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/qira</i>
---	-------------	----------	---------------------

*Mjeti i paraqitur nuk provon dot nuk disponon një fshesë qendrore rul dhe sistem thithës të pëlhurave.*

*Sa më sipër oferta e paraqitur duhet skualifikuar pasi nuk përmbush kriteret e parashikuara në DT dhe ligj.*

II.9. Në datën 02.06.2021 me shkresën nr.3819/1 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.10. Në datën 09.06.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.11. Në datën 01.06.2021 operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Ofertat e paraqitura nga shoqëria GPG Company ShPK dhe Rej ShPK duhen skualifikuar pasi nuk plotësojnë kriteret si më poshtë:*
  - *Shoqëria GPG nuk plotëson kriterin lidhur me punën e ngjashme sipas përcaktimeve të autoritetit në DT e konkretisht pikës 3.3 kapaciteti teknik. Kjo shoqëri nuk plotëson kriterin lidhur me punët e ngjashme dhe dokumentacioni i paraqitur është i pasaktë pasi kjo shoqëri nuk ushtron aktivitet në këtë fushë as me institucione shtetërore dhe as private pasi kjo shoqëri nuk e ka si objekt të aktivitetit të saj shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane dhe nuk ka asnjë licencë të lëshuar nga QKL me kod III.2.B nuk ka se si të ketë ushtruar aktivitet tregtar. Kjo gjë dallohet lehtësisht nga faturat e paraqitura se ato nuk përmbajnë të dhëna të detajuara se çfarë shërbimi është kryer, në çfarë sasish etj. Për rrjedhojë nga OE GPG Company ShPK nuk plotëson kriterin lidhur me përvojën e ngjashme.*
  - *Në DT është kërkuar lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelë. Kjo shoqëri nuk plotëson kriterin për kapacitetin teknik për mjetet në raport me përqindjen e marrë përsipër në marrëveshjen e noterizuar ku nga dispozita ligjore del qartësisht e përcaktuar se secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të përmbushë kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuar në aktmarrëveshje.*
  - *Edhe në kontratën e bashkëpunimit për shkak se shoqëria GPG ShPK nuk plotëson kriterin lidhur me punën e ngjashme dhe se faturat tatimore janë evazive në pjesën përshkruese të saj e për rrjedhojë palët në marrëveshjen e noterizuar thjesht kanë parashikuar përqindjen e marrë përsipër pa ndarë elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar kjo në kundërshtim me kreun VII neni 74 pika 2.*
  - *Nuk plotëson kriteret lidhur me mjetet e përcaktuara në DT lidhur me pikën 7 dhe 4 e konkretisht autoboti nuk është i pajisur me minimalisht me dy pjata larëse në pjesën e përparme dhe autofshesa nuk rezulton me kapacitet mbajtës 7-9 ton dhe nuk ka 2 fshesa anësore dhe 1 qendrore.*
  - *Shoqëria Rej ShPK nuk plotëson kriteret si më poshtë:*
  - *Licencë profesionale e shoqërisë e vlefshme me kategorinë NP-12-B (punime të inxhinierisë së mjedisit) sipas modelit të lëshuar nga MPPTT e vlefshme. Shoqëria Rej ShPK nuk ka paraqitur Licencën profesionale të shoqërisë me kategorinë NP-12-B.*
  - *Një punësim mesatar i të paktën 60 për periudhën Janar-Mars 2021. Kjo shoqëri nuk disponon një numër mesatar prej 60 punonjësish.*
- Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ofertës së OE GPG Company ShPK dhe Rej ShPK.*

II.12. Në datën 02.06.2021 me shkresën nr.3796/2 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dëgjimin lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.13. Në datën 14.06.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.4133/1 prot datë 14.06.2021 protokolluar me tonën me nr.1015/2 prot datë 16.06.2021, nr.4284/1 prot datë 18.06.2021 protokolluar me tonën me nr.1062/2 datë 21.06.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Leal” ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK me argumentin se *Operatori Alko Impex General Construction ShPK nuk ka mundur të paraqesë një mekanik me diplomë por ka paraqitur një certifikatë trajnimi nga institucione të paakredituar për dhënien e diplomave profesionale*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 3.3/5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar: 1 (një) teknik mekanik, shoqëruar me kontratë pune, diploma (deftesë) profesionale*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Alko Impex General Construction ShPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune datë 25.05.2019 lidhur ndërmjet Alko Impex General Construction ShPK dhe E.M në detyrën Inxhinierë Mekanike, Diplomë nr.2734 e E.D me itull Inxhinier Mekanik Drejtimi Energjetik , Libreze pune, Licencë M.1135/1 në Projektim, Licencë Për Mbikëqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, CV,

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*.

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

III.1.6. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë të 1 (një) tekniku mekanik, shoqëruar me kontratë pune, diploma (dëftesë) profesionale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex general Construction” SHPK, rezulton se në përmbushje të kërkesës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier mekanik konkretisht kontratë punë, Diplomë nr.2734 e E.D me titull Inxhinier Mekanik



Drejtimi Energjitik , Librezë pune, Licencë M.1135/1 në Projektim, Licencë Për Mbikëqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, CV. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” SHPK për teknik mekanik duke paraqitur dokumentacion për një inxhinier mekanik e përmbush dhe e tejkalon kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Leal” ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK me argumentin se *Operatori Alko Impex General Construction ShPK nuk ka mundur të paraqesë analizën e kostos ashtu siç është kërkuar nga ana e juaj*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk rezulton të jetë kërkuar paraqitja nga ana e operatorëve ekonomikë të analizës së kostos sikundër pretendon ankimuesi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Alko Impex General Construction ShPK ka dorëzuar në përputhje me përcaktimet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi Formularin e Ofertës, Preventivin e Ofertës të detajuar, dhe kalendarin e detajuar të realizimit të punimeve. Gjithashtu referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit sqarohet se: *Ju bëjmë me dije se operatori ekonomik ka plotësuar ofertën e tij dhe preventivat e detajuar me zëra dhe vlerat përkatëse sipas analizave të cilat në këtë rast janë ndihmëse për të ndihmuar operatorët që të plotësojnë preventivat e tyre ligjore sipas legjislacionit. Në këtë kuptim KPP gjykon se në kushtet kur në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është kërkuar analizë kostoje, mosparaqitja e saj nuk mund të jetë kusht skualifikues. Kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentet e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.**

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Leal” ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK me argumentin se *Po ashtu ky operator nuk ka mundur të paraqesë pompën speciale për larjen e kazanëve por ka paraqitur autobot uji*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 12 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet ndër të tjera si më poshtë:

*12. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

*Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:*

<b>6.</b>	<i>Makineri pompe special për larjen e kazaneve</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/qira</i>
-----------	---	-------------	----------	---------------------

*Shenim: Për Makinerite dhe Mjetet Teknologjike të kerkuara me sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:*

- *Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara ( kontrata shitblerjeje ose kontrata dhurimi)*
- *Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirase të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve ( e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi)*
- *Për mjetet që shihen në regjistri publik (me goma) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe foto.*
- *Për mjetet me qira (me goma), duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik, foto dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qirase/ furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. **Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe foto.***

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Alko Impex General Construction ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë Tatimore Shitje më përshkrim pompë lavazhi copë 1.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike:

*operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...*”.

III.3.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon*”

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik Alko Impex General Construction ShPK rezulton se ky i fundit ka paraqitur pompë speciale për larjen e kazanëve duke përmbushur kështu kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimeus Leal ShPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik Leal ShPK mbi kualifikimin e operatorëve të tjerë në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial* i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në*

*kundërshtim me ligjin.* Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 27.05.2021 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction”, mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Leal ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Rej ShPK dhe BOE GPG Company ShPK & Korsel ShPK nuk merren në shqyrtim.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Alko Impex General Construction ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Rej ShPK me argumentin se *Shoqëria Rej ShPK nuk ka paraqitur Licencën profesionale të shoqërisë me kategorinë NP-12-B*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 3.3.9 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Licence profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë NP-12-B (punime të inxhinierisë së mjedisit), sipas modelit të leshuar nga MPPTT, e vlefshme.*

III.7.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Në pikën 3.3.9 të Kapacitetit Teknik, Kërkohej: “Licence profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë NP-12-B (punime të inxhinierisë së mjedisit), sipas modelit të leshuar nga MPPTT, e vlefshme”. Ky kriter hiqet .*

III.4.3. Referuar sa më sipër KPP vëren se kriteri lidhur me Licence profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë NP-12-B (punime të inxhinierisë së mjedisit), sipas modelit të leshuar nga MPPTT, e vlefshme, nuk është më pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi duke mos qenë më një kriter skualifikues. Kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të

kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentet e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Alko Impex General Construction ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Rej ShPK me argumentin se “*Kjo shoqëri nuk disponon një numër mesatar prej 60 punonjësish*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtedhjetë e një personave, për periudhën Janar 2021- Mars 2021 të vërtetuar me:*

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2021- Mars 2021;*
- b. Listëpagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën **Janar 2021- Mars 2021** shoqëruar me formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”.*

**BEHET :**

### **3.3.4 Kapaciteti teknik:**

*“Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtedhjetë e një personave, për periudhën Janar 2021- Mars 2021 të vërtetuar me:*

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2021- Mars 2021;*
- b. Listepagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën Janar 2021- Mars 2021.*

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Rej ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Nr.T03943781 datë 22.04.2021 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën 04/2019-03/2021, nga ku rezulton se për periudhën janar 2021- mars 2021 ka një numër mestar prej 162.3 punonjës.

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Janar 2021-Mars 2021.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.5.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret operatori ekonomik Rej ShPK përmbush dhe tejkalon kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me numrin mesatar prej 60 punonjësish për periudhën Janar 2021-Mars 2021.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik Rej ShPK mbi kualifikimin e BOE GPG Company&Korsel ShPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit

Publik gjykon se parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rej”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 27.05.2021 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Rej” ShPK mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues Alko Impex General Construction ShPK mbi kualifikimin e BOE GPG Company ShPK & Korsel ShPK nuk merren në shqyrtim.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” ShPK mbi kualifikimin e ofertës së BOE “GPG Company ShPK & Korsel ShPK me argumentet se: *Duke qenë se shoqëria jonë ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e shërbimit të pastrimit e kryesisht atë të mbetjeve urbane kemi bindjen e plotë se shoqëria GPG Company nuk ka asnjë eksperiencë të ngjashme në këtë fushë. Konkretisht edhe nga një kërkim i kryer nga ana jonë në buletinin e prokurimeve publike nuk rezulton që kjo shoqëri të jetë shpallur fituese në ndonjë procedurë prokurimi të ngjashme me këtë procedurë objekt ankimi e për rrjedhojë kjo shoqëri nuk e plotëson kriterin e përvojës me institucione shtetërore. Për sa i përket pretendimit për realizim të kontratës me subjekte provate së pari çmujmë se faturat e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës dhe në to nuk shënohen saktë dhe qartë shërbimet e realizuara. Më tepër nga një kërkim i thjeshtë në faqen zyrtare të QKB nuk rezulton që kjo shoqëri të jetë e licencuar për asnjë prej veprimtarive të pretenduara të realizuara e si rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur është fiktiv dhe nuk plotëson ato parakushte të caktuara nga AK në DT, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

a. Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
- Kur shërbimi është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

III.7.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE GPG ShPK & Korsel ShPK e konkretisht anëtari i bashkimit GPG Company ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Akt-Marrëveshje (Kontratë bashkëpunimi për bashkimin e përkohshëm të dy shoqërive) lidhur para një noteri publik me Nr.4309 rep dhe Nr.771 kol datë 19.05.2021, ndërmjet Korsel ShPK dhe GPG Company ShPK për objektin e kontratës Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnje”, me fond limit 31,409,034 lekë pa TVSh. Përfaqësuesit e shoqërive kanë rënë dakord që raporti i pjesëmarrjes në këtë kontratë bashkëpunimi të jetë 70% shoqëria Korsel ShPK dhe punimet që do të kryejë, fshirje rrugëve dhe trotuareve, larje rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtje të pikave të grumbullimit të mbetjeve ...etj., ndërsa shoqëria GPG Company ShPK 30% dhe do të kryejë punime si heqje dhe transport i mbeturinave inerteve për vende depozitimi . Punimet që do të kryejnë shoqëritë janë sipas preventivit bashkëngjitur kësaj kontrate bashkëpunimi.
- Formulari i ofertës bashkëngjitur preventivi përmbledhës nga ku rezulton se shoqëria GPG ShPK ka marrë përsipër realizimin e zërave të shërbimit si më poshtë:
  - 1. Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim kontejner**
  - 2. Heqje e mbetjeve inerte**
  - 3. Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim**
- Kontratë Sipërmarrje Nr.1189/3 datë 13.03.2018 me objekt Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe GPG Company ShPK me vlerë 233,624,034 lekë me TVSh.
- Shtesë Kontratë Sipërmarrje Nr.13721/6 datë 10.04.2019 me vlerë 18,942,738 lekë me TVSh.
- Fatura tatimore shitje
- Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve në objektin Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat.
- Procesverbal Kolaudimi
- Situacion Progresiv Nr.3 Përfundimtar
- Formular Vlerësimi



III.7.3. Në nenin 28 pika 3 “Kontrata e Shërbimeve” të VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.7.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 i ndryshuar parashikohet se :

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.7.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.7.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit për përvojë të ngjashme anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë GPG Company ShPK ka dorëzuar një kontratë me objekt “Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe GPG Company ShPK me vlerë 233,624,034 lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, fatura tatimore, situacion përfundimtar, akt kolaudimi etj.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar e konkretisht kontratës së paraqitur dhe kontratës së bashkëpunimit në të cilën është bërë ndarja konkrete e zërave të marra përsipër nga anëtarët e bashkimit, konstaton se anëtari GPG Company ShPK ka marrë përsipër 30% të realizimit të zërave të shërbimit nga ku referuar preventivit konkret të ndarjes së zërave rezulton se zërat e shërbimit që do të realizojë janë :

- 1. Heqje dhe transporti i mbetjeve per ne venddepozitim kontejner**
- 2. Heqje e mbetjeve inerte**
- 3. Heqje dhe transporti i mbetjeve per ne venddepozitim**

III.7.7. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i bashkimit G.P.G Company ShPK. Komisioni gjykon se kontrata e paraqitur për plotësimin e kriterit punë të ngjashme ka për objekt të saj realizimin e punimeve për Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat, situacioni i të cilës dëshmon se anëtari i bashkimit GPG Company ka realizuar zërin Heqje dhe transportim i mbetjeve inerte në venddepozitim. Ndërkohë në preventivin e ndarjes së zërave të shërbimit mes anëtarëve KPP vëren se anëtari GPG Company ka marrë përsipër edhe realizimin e zërave Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim kontejner dhe Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim për të cilat anëtari i bashkimit me dokumentacionin e paraqitur nuk rezulton të provojë se ka eksperiencën e kërkuar. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme ose jo duhet parë në lidhje me zërat konkretë të punimeve të relizuara nga operatori ekonomik. Në rastin konkret vetëm njëri nga zërat e preventivit e marrë përsipër nga anëtari GPG Company rezulton të përputhet me zërin e kontratave të paraqitura ndërsa për zërat e tjerë të marrë përsipër i cili ka lidhje me transportin e mbetjeve për në venddepozitim /kontejner anëtari i bashkimit nuk ka dorëzuar dokumentacion provues që dëshmon se ka përvojë të ngjashme. KPP gjykon se eksperiencia e paraqitur nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve GPG Company ShPK që ka marrë përsipër realizimin e 30 % të zërave të shërbimit nuk dëshmon se ky i fundit ka realizuar shërbime të ngjashme me natyrën e objektit të prokurimit dhe me zërat konkretë të shërbimit të marra përsipër duke mos krijuar kështu bindjen e për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

III.7.8. KPP thekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve

ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “GPG Company” ShPK nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 3.3., të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi lidhur me përvojën e ngjashme.

III.7.9. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GPG Company” ShPK & “Korsel” ShPK nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi kriteri për përvojën e ngjashme nuk plotësohet nga njëri prej anëtarëve të bashkimit GPG Company ShPK.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik Rej ShPK qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik Rej ShPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik GPG Construction ShPK me argumentin se *nuk disponon licencë të lëshuar nga QKL me kod III.2.B*, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në pikën 3.3 pika 5 kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka kërkuar dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të Licence e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuara nga QKL. (Kodi III.2.B).

III.8.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike KPP konstaton se anëtari GPG Company ShPK nuk ka dorëzuar Licencën me Kod III.2.B Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuara nga QKL.

III.8.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën*

dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.8.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 i ndryshuar parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.8.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.8.6. Në nenin 26, pika 8, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

III.8.7. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” , nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo

*nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”*

III.8.8. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në kriterin e veçante të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë *Licencë me kodin III.2.B për grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “GPG Company” ShPK rezulton se nuk është dorëzuar Licencë kategoria III.2.B Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuara nga QKL. Ndërkohë referuar kontratës së bashkëpunimit dhe preventivit të ndarjes së zërave të shërbimit sikundër cituar më sipër anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë GPG Company ShPK ka marrë përsipër 30% të volumit të shërbimit e konkretisht zërat Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim kontejner; Heqje e mbetjeve inerte; Heqje dhe transporti i mbetjeve për në venddepozitim, për të cilat duhet të dispononte licencën përkatëse me kod III.2.B të kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit. Legjislacioni i sipërcituar konkretisht VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*. KPP sqaron se legjislacioni sektorial në fuqi ka një rregullim të ndryshëm për trajtimin e mbetjeve urbane dhe ato inerte.

III.8.9. Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “GPG Company” ShPK & “Korsel” ShPK nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi kriteri për Licencën me Kod III.2.B Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuara nga QKL nuk plotësohet nga njëri prej anëtarëve të bashkimit GPG Company ShPK.

III.8.10. Gjithashtu Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimes do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti*

*kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.*

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik Rej ShPK qëndrojnë.

III.9. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Rej” ShPK mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë GPG Company & Korsel ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë GPG Company & Korsel ShPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimesit.

III.10. Gjithashtu nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit atë të njoftim-fituesit. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara proceduralë në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.10.1. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “[...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.10.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesat e operatorëve ekonomikë ankimues duke i refuzuar ato. Me refuzimin e ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe dhënia e një vendimi të arsyetuar nga ky i fundit nuk heq pezullimin e procedurës së prokurimit parashikuar nga nenit 63 pika 3 e LPP. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet procedurale të ankimit duke vijuar me hapat e mëtejshëm të publikimit të njoftimit të fituesit, brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimues iu lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatorët ekonomikë ankimues kanë qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë KPP si në momentin e publikimit të njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit gjithashtu edhe në momentin e dorëzimit të ankesës pranë KPP. **Në këtë kuptim KPP gjykon se Njoftimi i Fituesit është një akt i dalë në kundërshtim me ligjin e rrjedhimisht duhet të anulohet nga autoriteti kontraktor.**

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Leal” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-91787-03-30-2021 me objekt “*Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnje*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës: 31 409 034 Lek pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnjë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” ShPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “GPG Company” ShPK & “Korsel” ShPK duke e skualifikuar atë.

5. Autoriteti Kontraktor të anulojë aktin administrativ “Njoftim Fituesi” si akt i dalë në kundërshtim me dispozitat ligjore.
6. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej ” ShPK.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1015 Protokolli; Datë 09.06.2021**

**Nr. 1016 Protokolli; Datë 09.06.2021**

**Nr.1062 Protokolli; Datë 14.06.2021**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**